



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 143, Datë 24.04.2023

MBI

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME RINOVIMIN E
LICENCËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SH.A., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 999/7 prot., datë 19.04.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 77, datë 15.03.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.03.2023 dhe 17.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 122, datë 04.04.2023 vendosi të zgjasë me 20 ditë vendimarrjen e bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a. me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- ERE me shkresën nr. 999/6, datë 18.04.2023 i është drejtuar shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a. duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të munguar. Në vijim shoqëria është përgjigjur duke depozituar në ERE informacion mbi ushtrimin e aktivitetit të licencuar.

- Sa rezulton nga dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë lind nevoja për saktësime/sqarime të dokumentacionit financiar. Në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 14, pika 3 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, me qëllim saktësim e dokumentacionit financiar, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje me rinovimin e licencës Nr. 422, Seria T18, të shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI